



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 436/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me nr. A-436 e datës 11.12.2010 kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK).

AAK-së i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4050 (katërmijepesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik PDK e cili ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*, Në ankesë theksohet se më datë 10.12.2010 në ora 18:25 në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, është vërejtur se subjekti politik AAK ka vendosur posterin e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Xhevat Olluri mbi atë të AAK-së lidhur me fushatën zgjedhore

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se posterit i subjektit politik AAK, është vendosur mbi atë të PDK-së.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik AAK, më datë 12.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 13.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar për të sqaruar lidhur me shkeljen e pretenduar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se poster i subjektit politik AAK është i vendosur mbi atë të AAK-së në rrugën “Dëmorët e Kombit” në Ferizaj, nga kjo arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur po ashtu në pajtim më dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 436/2010 më datën 23.12.2010

